



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**VENDIM**

**Nr. 131, datë 13.03.2024**

**PËR**

**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATI Z. {...}, TË TRE PREJ KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E SË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN E KËSHILLIT NR. 241 DATË 24.05.2023 DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenet 8, në nenin 47, pika 4, në nenin 48, pika 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar; si dhe në pikën 9, të Vendimit të tij nr. 241 datë 24.05.2023, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile”; pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i saj, z. Ridvan Hado,

**VENDOSI:**

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 241 datë 24.05.2023, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 241 datë 24.05.2023.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**